



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/04

Datë: 11.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/04
Datë: 11.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.03-V-074 të datës 12 dhjetor 2008 dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2011, mori

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë, Nr. 08/39 i datës 08.10.2008 për themelimin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike.
2. Komisioni Qeveritar do të jetë në këtë përbërje:
 - 2.1 Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, kryesues;
 - 2.2 Znj. Mimoza Kusari Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, anëtare;
 - 2.3 Z. Bedri Hamza, Ministër i Financave, anëtar;
 - 2.4 Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 2.5 Z. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
3. Komisioni Qeveritar sipas pikës 2. të këtij vendimi do të vazhdojë me procesin e privatizimit të Kompanisë Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe shfuqizon Vendimin nr 08/39 datë 08.10.2008.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë